

fakte

Dhuna nga partneri intimë

Njëra prej formave më të shpeshta të dhunës kundër grave është dhuna e kryer nga ana e bashkëshortit ose partnerit intim mashkull. Edhe pse gratë mund të jenë të dhunshme përkundrejt burrave, dhunë është parë edhe tek partnerët nga e njejta gjini, prap se prap problemet shëndetësore nga dhuna e partnerit mbizotrojnë dhe i bartin gratë.

Dhuna nga partneri intim përfshin akte të sulmeve fizike, maltretimeve psikologjike, marrëdhënieve seksuale të detyruara si dhe forma të tjera të detyrimit seksual, sjellje të ndryshme kontrolluese, p.sh. izolimi i personit nga familja e saj dhe shoqëria ose kufizim i mundësis së saj për qasje ndaj informacioneve dhe ndihmës.

SHKALLA E PROBLEMIT

Dhuna nga partneri intim në kohë të fundit shumë e më shumë shihet si problem i rëndësishëm i shëndetësis publike.

- Në 48 kërkime të popullatës nga e gjithë bota, 10-69% e grave kanë paraqitur se kanë qenë të sulmuara fizikisht nga partneri intim mashkull në ndonjë moment të jetës së tyre. Në studimet e mëdha nacionale numri sillet ndërmjet 10 dhe 34%.
- Shumica e viktimave të agresionit fizik u janë të nënshtruara akteve të shumfishta të dhunës gjatë një periudhe më të gjatë kohore.
- Dhuna fizike në marrëdhëniet intime shpesh herë është e shoqëruar nga keqpërdorimi psikik, kurse në një të tretën deri në gjysmën e rasteve janë të shoqëruara edhe me dhunë seksuale.
- Nga dhuna e partnerit vijnë edhe një numër i konsiderueshëm i grave të vdekura. Studime nga një numër i madhë i vendeve tregojnë se 40-70% e grave-viktima të vrasjeve kanë qenë të vrara nga burrat e tyre ose të dashurit shpesh herë në marrëdhënie të përhershme e cila ka qenë përplot e mbushur me maltretime.

KOEFICIENTI I GRAVE TË CILAT KANË QENË FIZIKISHT TË SULMUARA NGA PARTNERI INTIM—STUDIME NACIONALE TË ZGJEDHURA

Vendi	Viti	Madhësia e ekzemplarit	Koeficienti i grave të sulmuara nga partneri intim (%)
Kanadaja	1991-1992	12 300	29
Egjipti	1995-1996	7 121	34
Nikaragua	1998	8 507	28
Paraguaji	1995-1996	5 940	10
Filipinet	1993	8 481	10
Afrika J.	1998	10 190	13
Zvicra	1994-1996	1 500	21
SHBA	1995-1996	8 000	22

PASOJAT NGA DHUNA E PARTNERIT INTIM

Dhuna nga partneri intim lidhet me shumë pasoja shëndetësore afatgjate dhe akute, edhe atë:

- lëndime fizike,
- çrregullime gastrointestinale,
- sindrome kronike të dhembjes,
- sjellje depresive dhe vetëvrasëse.

Dhuna nga partneri e godet edhe shëndetin riprodktiv dhe mund të sjellë deri tek çrregullime gjinekologjike, shtatëzani të padëshirueshme, lindje të parakohshme si dhe sëmundje seksualisht të bartëshme dhe HIV/SIDA.

Mesatarisht viktimat e dhunës nga partneri gjatë jetës së tyre përjetojnë më shumë intervenime kirurgjike, vizita mjekësore dhe qëndrime spitalore sesa ato pa histori të keqpërdorimit dhe maltretimeve.

Edhe pse dhuna nga partneri nuk ndikon në mundësin e përgjithshme që gruaja të gjenë punësim, ajo mund të ndikonë në të ardhurat e saja, rezultatet në punë dhe aftësin e saj që ta mban punën.



Organizata
botërore
e shëndetësisë



Ministria e
shëndetësis, RM




Enti Republikan
për mbrojtje
shëndetësore



Fondacioni Instituti i
Hapur i Shoqëris Civile
në Maqedoni



Shoqata për emancipim,
solidaritë dhe barazi
gjinore në RM



CILËT JANË FAKTORËT-RREZIK PËR DHUNË NGA PARTNERI INTIM?

Shumë faktor lidhen me rrezikun që burri ta sulmon partnerin intim, duke përfshir:

- moshën e re,
- të ardhurat e ulta,
- nivel i ulët arsimor,
- përfshirja në sjellje delikvente apo agresive gjatë periudhës adoleshente.

Historia e dhunës në familje të partnerit mashkull (veçanërisht nëse ka parë se si është rrahur nëna e tij ose nëse ka përjetuar dhunë si i vogël) si dhe rritja në familje të varfër mund të jenë gjithashtu faktorë të rëndësishëm të lidhura me kryerjen e dhunës nga partneri.

Shumë studime tregojnë se përdorimi i tepërt i alkoolit është ngushtë i lidhur me kryerjen e dhunës nga partnerët edhe pse zhvillohet debat nëse pierja e tepërt i bën burrat të dhunshëm ose ajo vetëm shfrytëzohet si pretekst për sjelljen e tyre të dhunshme.

Faktorë të caktuar të personalitetit, përfshirë këtu pasigurinë, vetërespektin e ulët, depresionin dhe çrregullimet antisociale apo agresive të personit lidhen ngushtë me dhunën nga partnerët, gjithashtu këtu mund të shtohen edhe faktorët e mosëharmonisë dhe konfliktit në lidhje materiale.

Gratë janë posaçërisht të nënshtruara ndaj keqpërdorimit nga partnerët e tyre në shoqëri ku egzistojnë pabarazi të qarta në mes burrave dhe grave, aty ku në mënyrë strikte janë ta ndara rolet gjinore, normat kulturore të cilat e përkrahin të drejtën e burrit që të jetë i dhunshëm me partneren e tij intime dhe gjithashtu këtu zënë një vend të veçantë dënimet e dobëta për sjellje të këfill.

ÇKA MUND TE BËHET QË TË PARANDALOHET DHUNA NGA PARTNERI INTIM?

Përpjekjet për luftë kundër dhunës nga partneri në masë të madhe fokusohen në:

- përkrahjen e viktimave,
- reformave juridike dhe trajnim të policëve,
- programe për mjekim të kryesve.

Qendrat e krizës të grave dhe strehimoret për gra të rrahura janë mure-mbështetës për programet e ndryshme për përkrahje të viktimave të dhunës nga partneri. Këto lloj programe ofrojnë këshillime individuale, trajnim për punë dhe ndihmë gjatë ballafaqimit me shërbime të ndryshme sociale dhe punët juridike. Disa prej tyre japin edhe udhëzime për mjekim nga droga dhe alkooli.

Reformat juridike, veçanërisht inkriminimi i dhunës familjare dhe përpjekjeve që të reformohet praktika

policore janë gjithashtu metoda të zakonshme për adresimin e dhunës nga partneri. Mirëpo, përvoja tregon se këto reforma nuk kanë gjasa të japin efekte, vetëm nëse shoqërohen nga ndryshime të rëndësishme në kulturën dhe praktikën institucionale.

Programet për mjekimin e personave që përdorin dhunë zakonisht përdorin grupe për të diskutuar për rolet gjinore dhe për mësimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve. Programet këshilluese për burra të cilët i kanë maltretuar partneret e tyre janë treguar shumë të sukseshme në ndihmë të disa burrave për ta ndryshuar sjelljen e tyre, por shumë shpesh shkalla e tërheqjes nga programe të tilla është shumë e lartë, shumë prej tyre të cilët drejtohen në programe të këtylla asnjëherë nuk marrin pjesë në seanca.

Përpjekje tjera për adresimin e dhunës nga partneri intim koncentrohen në mjedise të caktuara, si:

- spitale dhe mjedise tjera shëndetësore,
- shkolla,
- bashkësi.

Gjatë jetës, gratë janë në kontakt me sistemin shëndetësor. Kjo e bën mjedisin shëndetësor vend të rëndësishëm ku gruaja që përjeton maltretim mund të zbulohet, mund t'i jepet përkrahje dhe nëse është e nevojshme të drejtohet për kujdes nga specialisti. Intervenimet e përhershme në mjediset shëndetësore fokusohen në trajnimin e dhënsve të shërbimeve shëndetësore se si të njohin dhe të reagojnë ndaj viktimave të keqpërdorura dhe gjithashtu në përgatitjen e udhëzimeve për trajtimin adekuat të keqpërdorueses.

Shkollat janë mjedis shumë i rëndësishëm për aktivitete për preventim primar. Dhe derisa shumica e programeve nëpër shkolla i trajtojnë dhunën rinore dhe frigësimin egziston një vend i dukshëm për integrim të një materiali të tillë në këto programe i cili i sheh marrëdhëniet, rolet gjinore, detyrimet dhe kontrollin. Promovimi i marrëdhënieve të shëndosha tek grupet e moshave më të reja është çelësi për parandalimin e dhunës dhe modeleve destruktive të sjelljes.

Këshillet koordinative ose forumet ndër agjensive janë në kohë të fundit shumë e më shumë të popullarizuara si mjet për përcjelljen dhe përmirësimin e reaksioneve ndaj dhunës nga partneri intim në nivel të bashkësis. Qëllimi i tyre është të shkëmbejnë informata, ti përcaktojnë dhe adresojnë problemet në sigurimin e shërbimeve si dhe ti përparojnë praktikën e mira dhe vetëdijën.

Aktivitetet tjera në bashkësi përfshijnë punë me viktimat në terren dhe fushata preventive në medime lokale për ngritjen e vetëdijes për problemin dhe për ndërrimin e normave shoqërore të sjelljes.